



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 10.04.2019, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z. IGOR RAJČIĆ** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut nga subjekti politik "GI SDP- Oliver Ivanović" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Marko Jakšić.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Igor Rajčić dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

## Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 01.04.2019, Nr.236/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit komunal z. Marko Jakšić, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është, z. Igor Rajčić nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 10.04.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
Valdete Daka

